

Kudri për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare

Kudri i BSNK u miratua nga Bordi i KSNK në prill 1989 për publikim në korrik 1989 dhe u pranua nga BSNK në prill 2001.

PËRMBAJTJA

paragrafët

PARATHËNIE	
HYRJE	1–11
Qëllimi dhe statusi	1–4
Objekti	5–8
Përdoruesit dhe nevojat e tyre për informacion	9–11
OBJEKTIVI I PASQYRAVE FINANCIARE	12–21
Gjendja financiare, rezultati financiar dhe ndryshimet në gjendjen financiare	15–21
Shënimet shpjeguese dhe pasqyrat shtesë	21
SUPOZIMET THEMELORE	22–23
Baza e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara	22
Vijimësia	23
KARAKTERISTIKA CILËSORE TË PASQYRAVE FINANCIARE	24–46
Kuptueshmëria	25
Përkatësia	26–30
Materialiteti	29–30
Besueshmëria	31–38
Paraqitja me besnikëri	33–34
Përmbajtja mbi formën	35
Neutraliteti	36
Kujdesi	37
Plotësia	38
Krahasueshmëria	39–42
Kufizimet ndaj informacionit përkatës dhe të besueshëm	43–45
Përshtatshmëria në kohë	43
Peshimi mes përfitimit dhe kostos	44
Drejtëpeshimi mes karakteristikave cilësore	45
Pamja e vërtetë dhe e sinqertë/paraqitja e sinqertë	46
ELEMENTËT E PASQYRAVE FINANCIARE	47–81
Gjendja financiare	49–52
Aktivitet	53–59
Detyrimet	60–64
Kapitali i vet	65–68
Rezultati financiar	69–73
Të ardhurat	74–77
Shpenzimet	78–80
Rregullimet e mbajtjes së kapitalit	81
NJOHJA E ELEMENTËVE TË PASQYRAVE FINANCIARE	82–98
Mundësia e përfitimeve ekonomike në të ardhmen	85
Besueshmëria e vleresimit	86–88
Njohja e aktiveve	89–90
Njohja e detyrimeve	91
Njohja e të ardhurave	92–93
Njohja e shpenzimeve	94–98
I ELEMENTËVE TË PASQYRAVE FINANCIARE	99–101

KONCEPTET E KAPITALIT DHE MBAJTJES SË KAPITALIT	102–110
Konceptet e kapitalit	102–103
Konceptet e mbajtjes së kapitalit dhe të përcaktimit të fitimit	104–110

Parathënie

Pasqyrat financiare përgatiten dhe paraqiten për përdoruesit e jashtëm prej shumë njësive ekonomike rreth e qark botës. Megjithëse këto pasqyra financiare mund të duken të ngjashme nga një vend në tjetrin, ka ndryshime që ndoshta shkaktohen nga një llojshmëri rrethanash shoqërore, ekonomike dhe ligjore dhe nga fakti që në vende të ndryshme mbahen parasysh përdorues të ndryshëm të pasqyrave financiare kur vendosen kërkesat kombëtare.

Këto rrethana të ndryshme kanë çuar në përdorimin e një llojshmërie përkufizimesh për elementët e pasqyrave financiare; që janë, për shembull, aktivet, detyrimet, kapitali i vet, të ardhurat dhe shpenzimet. Ato gjithashtu kanë çuar në përdorimin e kriterëve të ndryshme për njohjen e elementëve në pasqyrat financiare dhe në preferimin e bazave të ndryshme të vleresimit. Gjithashtu është ndikuar dhe objekti i pasqyrave financiare dhe dhënies së informacionit shpjegues në to.

Komiteti i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (KSNK) është i angazhuar për të zbutur këto dallime duke kërkuar të harmonizojë rregulloret, standardet e kontabilitetit dhe procedurat që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Ai beson se harmonizimi i mëtejshëm mund të arrihet më mirë duke u përqëndruar në pasqyrat financiare që përgatiten për qëllimin e dhënies së informacionit që është i dobishëm kur merren vendimet ekonomike.

Bordi i KSNK beson se pasqyrat financiare të përgatitura për këtë qëllim plotësojnë nevojat e përbashkëta të shumicës së përdoruesve. Kjo për arsye se pothuaj të gjithë përdoruesit marrin vendime ekonomike, për shembull, për:

- (a) të vendosur kur të blejnë, të mbajnë ose të shesin një investim të kapitalit të vet;
- (b) të vlerësuar përkujdesjen ose përgjegjshmërinë e drejtimit;
- (c) të vlerësuar aftësinë e njësisë ekonomike për të paguar dhe për të dhënë përfitimet e tjera punonjësve të saj;
- (d) të vlerësuar sigurinë e shumave që i janë dhënë hua njësisë ekonomike;
- (e) të përcaktuar politikatat tatimore;
- (f) të përcaktuar fitimet dhe dividendët e shpërndarshëm;
- (g) të përgatitur dhe përdorur statistikat e të ardhurave kombëtare; ose
- (h) të rregulluar veprimtaritë e njësive ekonomike.

Bordi megjithatë njih, që veçanërisht qeveritë, mund të specifikojnë kërkesa të ndryshme ose shtesë për qëllimet e veta. Këto kërkesa, megjithatë, nuk duhet të ndryshojnë pasqyrat financiare të publikuara për përfitimin e përdoruesve të tjerë përveç se kur ato gjithashtu plotësojnë nevojat e këtyre përdoruesve të tjerë.

Pasqyrat financiare zakonisht përgatiten më shumë në përputhje me një model kontabiliteti të bazuar në koston historike të rikuperueshme dhe në konceptin e mbajtjes financiare të kapitalit nominal. Modele dhe koncepte të tjera mund të janë më të përshtatshëm për të plotësuar objektivin e dhënies së informacionit që është i dobishëm për marrjen e vendimeve ekonomike megjithëse aktualisht nuk ka ndonjë konsensus për ndryshim. Ky *Kuatër* është përpunuar në atë mënyrë që të jetë i zbatueshëm për një gamë të modeleve të kontabilitetit dhe koncepteve të kapitalit dhe mbajtjes së kapitalit.

Hyrje

Qëllimi dhe statusi

1 Ky *Kuatër* parashikon konceptet që janë në themel të përgatitjes dhe paraqitjes së pasyrave financiare për përdoruesit e jashtëm. Qëllimi i *Kuatrit* është të:

- (a) ndihmojë Bordin e KSNK në përpunimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në të ardhmen dhe në rishikimin prej tij të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ekzistuese;
- (b) ndihmojë Bordin e KSNK për promovimin e harmonizimit të rregulloreve, standardeve të kontabilitetit dhe procedurat që lidhen me paraqitjen e pasqyrave financiare duke dhënë një bazë për zvogëlimin e numrit të trajtimeve kontabël alternative që lejohen nga Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit;
- (c) ndihmojë organizmat kombëtare të përcaktimit të standardeve për të përpunuar standarde kombëtare;
- (d) ndihmuar përgatitësit e pasqyrave financiare në zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe në trajtimin e çështjeve të cilat akoma nuk janë subjekt i një Standardi Ndërkombëtar të Kontabilitetit;
- (e) ndihmojnë audituesit për të formuar një opinion nëse pasqyrat financiare janë apo jo konform Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit;

- (f) ndihmojnë përdoruesit e pasqyrave financiare për të interpretuar informacionin që përmbajnë pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit; dhe
- (g) japin për ata të cilët interesohen për punën e KSNK informacione rreth metodave të tij për të formuluar Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.
- 2 Ky *Kudri* nuk është një Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit dhe kështu nuk përkufizon standarde për ndonjë çështje të veçantë vleresimi ose dhënie informacionesh shpjeguese. Asgjë në këtë *Kudri* nuk i mbivendoset asnjërit Standard Ndërkombëtar të Kontabilitetit.
- 3 Bordi i KSNK njih që në një numër të kufizuar rastesh mund të ketë një konflikt mes *Kudrit* dhe një Standardi Ndërkombëtar të Kontabilitetit. Në këto raste kur ka një konflikt, kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit mbizotërojnë ndaj atyre të *Kudrit*. Megjithatë, duke patur parasysh se Bordi i KSNK do të udhëhiqet nga *Kudri* në përpunimin e Standardeve në të ardhmen dhe në rishikimin prej tij të Standardeve ekzistuese, numri i rasteve të konfliktit mes *Kudrit* dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit do të ulet në kohë.
- 4 *Kudri* do të rishikohet nga koha në kohë mbi bazën e përvojës së Bordit duke punuar me të.

Objekti

- 5 *Kudri* trajton:
- (a) objektivin e pasqyrave financiare;
- (b) karakteristikat cilësore që përcaktojnë dobishmërinë e informacionit në pasqyrat financiare;
- (c) përkufizimin, njohjen dhe vleresimin e elementëve prej të cilëve ndërtohen pasqyrat financiare; dhe
- (d) konceptet e kapitalit dhe mbajtjes së kapitalit.
- 6 *Kudri* është i lidhur me pasqyrat financiare për qëllim të përgjithshëm (këtej e tutje u referohemi si ‘pasqyrat financiare’) përfshirë pasqyrat financiare të konsoliduara. Këto pasqyra financiare përgatiten dhe paraqiten të paktën çdo vit dhe drejtohen për nevojat e përbashkëta të informacionit të një game të gjërë përdoruesish. Disa prej këtyre përdoruesve mund të kërkojnë, si dhe kanë pushtetin për të marrë, informacione shtesë prej atij që përmbajnë pasqyrat financiare. Megjithatë, shumë përdorues duhet të mbështeten në pasqyrat financiare si burimi kryesor i tyre i informacionit financiar dhe këto pasqyra financiare, për këtë, duhet të përgatiten dhe paraqiten duke marrë parasysh nevojat e tyre. Raportet financiare për qëllim të veçantë, për shembull, pasqyrat dhe përlllogaritjet e përgatitura për qëllimet tatimore, janë jashtë objektit të këtij *Kudri*. Megjithatë, *Kudri* mund të zbatohet në përgatitjen e këtyre raporteve për qëllim të veçantë kur e lejojnë kërkesat e tyre.
- 7 Pasqyrat financiare janë pjesë e procesit të raportimit financiar. Një komplet i plotë i pasqyrave financiare normalisht përfshin një bilanc, një pasqyrë të ardhurash e shpenzimesh, një pasqyrë e ndryshimeve në gjendjen financiare (e cila mund të paraqitet në mënyra të ndryshme, për shembull, si një pasqyrë e flukseve të mjeteve monetare ose një pasqyrë e flukseve të fondeve), dhe ato shënime shpjeguese dhe pasqyra të tjera si dhe materiali tjetër shpjegues që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare. Ato gjithashtu mund të përfshijnë pasqyra shtesë dhe informacione të bazuara mbi ose të nxjerra nga, që pritet të lexohen bashkë me, këto pasqyra. Këto pasqyra dhe informacione shtesë mund të trajtojnë, për shembull, informacion financiar rreth segmenteve industrialë dhe gjeografikë dhe informacione të dhëna shpjeguese rreth efekteve të ndryshimit të çmimeve. Megjithatë, pasqyrat financiare nuk përfshijnë elementë të tillë si raportet nga drejtorët, pasqyrat nga kryetari, diskutime dhe analiza nga drejtimi dhe elementë të ngjashëm që mund të përfshihen në një raport financiar ose vjetor.
- 8 *Kudri* zbatohet për pasqyrat financiare për të gjitha njësitë ekonomike tregtare, industriale dhe bizneset, qoftë në sektorin publik ose qoftë në atë privat. Një njësi raportuese është një njësi ekonomike për të cilën ka përdorues të cilët mbështeten në pasqyrat financiare si burimin kryesor të tyre për informacion financiar rreth njësisë ekonomike.

Përdoruesit dhe nevojat e tyre për informacion

- 9 Përdoruesit e pasqyrave financiare përfshijnë investitorët aktual dhe të mundshëm, punonjësit, huadhënësit, furnitorët dhe kreditorë të tjerë tregëtar, klientët, qeveritë dhe organizmat e tyre dhe publiku. Ata përdorin pasqyrat financiare në mënyrë që të kënaqin nevojat e tyre të ndryshme për informacion. Këto nevoja përfshijnë si mëposhtë:
- (a) *Investitorët*. Ata që japin kapital me rrezik dhe këshilltarët e tyre janë të interesuar për rrezikun e vetvetishëm në, dhe shpërblimin e dhënë nga, investimet e tyre. Ata kanë nevojë për informacion për t’i ndihmuar të vendosin nëse ata duhet të blejnë, të mbajnë ose të shesin. Aksionerët gjithashtu janë të interesuar për informacionin i cili i mundëson atyre të vlerësojnë aftësinë e njësisë ekonomike për të paguar dividendë.

- (b) *Punonjësit.* Punonjësit dhe grupet përfaqësuese të tyre janë të interesuar për informacion rreth qëndrueshmërisë dhe rentabilitetit të punëdhënësve të tyre. Ata gjithashtu janë të interesuar për informacion që u mundëson atyre të vlerësojnë aftësinë e njësive ekonomike për të dhënë shpërblimin, përfitimet e pensioneve dhe mundësitë e punësimit.
 - (c) *Huadhënësit.* Huadhënësit interesohen për informacion që u mundëson atyre të përcaktojnë nëse huatë e tyre, dhe interesi i lidhur me to, do të paguhet në kohën e duhur.
 - (d) *Furnitorët dhe kreditorët e tjerë tregëtar.* Furnitorët dhe kreditorët e tjerë tregëtar interesohen për informacion që u mundëson atyre të përcaktojnë nëse shumat që ju detyrohen atyre do të paguhet në kohën e duhur. Kreditorët tregëtar ka mundësi të interesohen në një njësi ekonomike gjatë një periudhe më të shkurtër se sa huadhënësit përveç se kur ata janë të varur nga vazhdimi i njësive ekonomike si klient kryesor.
 - (e) *Klientët.* Klientët kanë interes për informacion rreth vazhdimësisë të një njësie ekonomike, veçanërisht kur ata kanë një angazhim afatgjatë me, ose janë të varur nga, njësia ekonomike.
 - (f) *Qeveritë dhe organizmat e tyre.* Qeveritë dhe organizmat e tyre interesohen për shpërndarjen e burimeve dhe, për këtë, për veprimtaritë e njësive ekonomike. Ata gjithashtu kërkojnë informacion në mënyrë që të rregullojnë veprimtaritë e njësive ekonomike, të vendosin politikatat tatimore dhe si bazë për statistikat e të ardhurave kombëtare dhe statistika të ngjashme.
 - (g) *Publiku.* Njësitë ekonomike ndikojnë në pjestarët e publikut në mënyra të ndryshme. Për shembull, njësitë ekonomike mund të japin një kontribut themelor për ekonominë e vendit në shumë mënyra përfshirë numrin e njerëzve që ata punësojnë dhe përkrahjen e tyre për furnitorët vendas. Pasqyrat financiare mund të ndihmojnë publikun duke dhënë informacion rreth tendencave dhe zhvillimeve të fundit në prosperitetin e njësive ekonomike dhe gamën e veprimtarive të saj.
- 10 Ndërsa të gjitha nevojat për informacion të këtyre përdoruesve nuk mund të plotësohen nga pasqyrat financiare, ka nevoja të cilat janë të përbashkëta për të gjithë përdoruesit. Ndërsa investitorët janë ata që japin kapital me rrezik për njësinë ekonomike, paraqitja e pasqyrave financiare që plotëson nevojat e tyre gjithashtu do të plotësojë shumicën e nevojave të përdoruesve të tjerë të këtyre pasqyrave financiare.
- 11 Drejtimi i një njësie ekonomike ka përgjegjësi parësore për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të njësive ekonomike. Drejtimi gjithashtu është i interesuar për informacionin që përmbajnë pasqyrat financiare edhe përse ai ka të drejtë hyrje në informacione financiare dhe të drejtimin shtesë që i ndihmon të kryejnë detyrat e tyre për planifikimin, marrjen e vendimeve dhe kontrollin. Drejtimi ka aftësinë për të përcaktuar formën dhe përmbajtjen e këtij informacioni shtesë në mënyrë që të plotësojë nevojat e veta. Raportimi i këtij informacioni, megjithatë, është jashtë objektivit të këtij *Kuardri*. Megjithatë, pasqyrat financiare të publikuara bazohen në informacionin e përdorur nga drejtimi rreth gjendjes financiare, rezultatit financiar dhe ndryshimeve në gjendjen financiare të njësive ekonomike.

Objektivi i pasqyrave financiare

- 12 Objektivi i pasqyrave financiare është të japin informacion lidhur me gjendjen financiare, rezultatit financiar dhe ndryshimet e gjendjes financiare të një njësie ekonomike që është i dobishëm për një grup të gjerë përdoruesish në marrjen e vendimeve ekonomike.
- 13 Pasqyrat financiare të përgatitura për këtë qëllim plotësojnë nevojat e përbashkëta të shumicës së përdoruesve. Megjithatë, pasqyrat financiare nuk japin të gjitha informacionet që përdoruesit mund të kenë nevojë që të marrin vendimet ekonomike përderisa ato në përgjithësi portretizojnë efektet financiare të ngjarjeve të shkuara dhe nuk japin domosdoshmërisht informacione jo-financiare.
- 14 Pasqyrat financiare gjithashtu tregojnë rezultatet e përkujdesjes së drejtimin, apo përgjegjshmërinë e drejtimin për burimet që u janë besuar. Ata përdorues të cilët dëshirojnë të vlerësojnë përkujdesjen e drejtimin e bëjnë këtë në mënyrë që ata të mund të marrin vendime ekonomike; këto vendime mund të përfshijnë, për shembull, nëse të mbajnë ose shesin investimin e tyre në njësinë ekonomike ose nëse të rriemërojnë ose të zëvendësojnë drejtimin.

Gjendja financiare, rezultati financiar dhe ndryshimet në gjendjen financiare

- 15 Vendimet ekonomike që merren nga përdoruesit e pasqyrave financiare kërkojnë një vlerësim të aftësisë së një njësie ekonomike për të krijuar mjete monetare e ekuivalentë të mjeteve monetare dhe për kohën dhe sigurinë e krijimit të tyre. Kjo aftësi në fund të fundit përcakton, për shembull, mundësinë e një njësie ekonomike për të paguar punonjësit e saj dhe furnitorët, të plotësojë pagesat e interesit, të shlyejë huatë dhe të shpërndajë fitime për pronarët e tij. Përdoruesit kanë më shumë mundësi të vlerësojnë këtë aftësi për të gjeneruar mjete monetare

dhe ekuivalentët e tyre nëqoftëse atyre u jepet informacion që përqëndrohet në gjendjen financiare, rezultatit financiar dhe ndryshimet në gjendjen financiare.

- 16 Gjendja financiare e një njësie ekonomike ndikohet nga burimet ekonomike që ajo kontrollon, struktura financiare e saj, likuiditeti dhe aftësia e saj paguese, si dhe mundësia e saj për t'u përshtatur me ndryshimet në mjedisin që ajo funksionon. Informacioni rreth burimeve ekonomike që kontrollohen nga njësia ekonomike dhe mundësia e saj për të ndryshuar këto burime është i dobishëm për parashikimin e aftësisë së njësisë ekonomike për të gjeneruar mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në të ardhmen. Informacioni rreth strukturës financiare është i dobishëm për të parashikuar nevojat për huamarrje në të ardhmen dhe se si do të shpërndahen fitimet e ardhëshme mes atyre që kanë interesa në njësinë ekonomike; ai gjithashtu është i dobishëm për të parashikuar se sa e suksesshme ka mundësi të jetë njësia ekonomike për të marrë financime të tjera. Informacioni rreth likuiditetit dhe aftësisë paguese është i dobishëm për të parashikuar aftësinë e njësisë ekonomike për të plotësuar angazhimet e saj financiare në kohën e duhur. Likuiditeti i referohet disponimit të mjeteve monetare në të ardhmen e afërt mbasi merren parasysh angazhimet financiare gjatë asaj periudhe. Aftësia paguese i referohet disponimit të mjeteve monetare gjatë një periudhe afatgjatë për të plotësuar angazhimet financiare në kohën e duhur.
- 17 Informacioni rreth rezultatit financiar të një njësie ekonomike, veçanërisht rentabiliteti i saj, kërkohet në mënyrë që të vlerësohen ndryshimet e mundshme në burimet ekonomike që ajo ka mundësi të kontrollojë në të ardhmen. Informacioni rreth ndryshueshmërisë së rezultatit financiar është i rëndësishëm në lidhje me këtë. Informacioni rreth rezultatit financiar është i dobishëm në parashikimin e mundësisë së njësisë ekonomike për të gjeneruar flukse monetare nga burimet e saj bazë ekzistuese. Ai gjithashtu është i dobishëm për të formuar gjykime rreth efektivitetit me të cilin njësia ekonomike mund të marrë burime shtesë.
- 18 Informacioni në lidhje me ndryshimet në gjendjen financiare të një njësie ekonomike është i dobishëm në mënyrë që të vlerësohen veprimtaritë e saj të investimit, financimit dhe operative gjatë periudhës raportuese. Ky informacion është i dobishëm për t'i dhënë përdoruesit një bazë për të vlerësuar aftësinë e njësisë ekonomike për të gjeneruar mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe nevojat e njësisë ekonomike për të përdorur këto flukse monetare. Në ndërtimin e një pasqyre të ndryshimeve në gjendjen financiare, fondet mund të jepen në mënyra të ndryshme, të tilla si të gjitha burimet financiare, kapitali punues, aktivet likuide ose mjete monetare. Në këtë *Kuadër* nuk është bërë asnjë përpjekje për të dhënë një përkufizim për fondet.
- 19 Informacioni rreth gjendjes financiare jepet kryesisht në një bilanc. Informacioni rreth rezultatit financiar jepet kryesisht në një pasqyrë të ardhurash e shpenzimesh. Informacioni rreth ndryshimeve në gjendjen financiare jepet në pasqyra financiare nëpërmjet një pasqyre të veçantë.
- 20 Pjesët përbërëse të pasqyrave financiare ndërthuren sepse ato pasqyrojnë aspekte të ndryshme për të njëjtat transaksione ose ngjarje të tjera. Megjithëse secila pasqyrë jep informacion që është i ndryshëm nga të tjerat, asnjëra prej tyre nuk mund të shërbejë për një qëllim të vetëm ose të japë të gjithë informacionin e nevojshëm për nevojat e veçanta të përdoruesve. Për shembull, një pasqyrë të ardhurash e shpenzimesh jep një pamje jo të plotë të rezultatit financiar po nuk u përdor sëbashku me bilancin dhe pasqyrën e ndryshimeve në gjendjen financiare.

Shënimet shpjeguese dhe pasqyrat shtesë

- 21 Pasqyrat financiare gjithashtu përmbajnë shënime shpjeguese dhe pasqyra shtesë dhe informacione të tjera. Për shembull, ato mund të përmbajnë informacion shtesë që është i nevojshëm për nevojat e përdoruesve rreth elementëve në bilanc dhe në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve. Ato mund të përfshijnë dhënie informacionesh shpjeguese rreth rreziqeve dhe pasigurive që ndikojnë në njësinë ekonomike dhe ndonjë burimi dhe detyrimi që nuk është njohur në bilanc (të tilla si rezervat minerare). Informacioni rreth segmenteve gjeografike dhe industriale dhe efektin ndaj njësisë ekonomike të ndryshimit të çmimeve gjithashtu mund të jepen në formën e informacionit shtesë.

Supozimet themelore

Baza e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara

- 22 Në mënyrë që të plotësojnë objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj baze, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen kur ato ndodhin (dhe jo kur mjetet monetare ose ekuivalentët e tyre janë arkëtuar ose paguar) dhe ato regjistrohen në regjistrat kontabël dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhave me të cilat ato lidhen. Pasqyrat financiare të përgatitura mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara informojnë përdoruesit jo vetëm për transaksionet e shkuara që përfshijnë pagesën dhe arkëtimin e mjeteve monetare por gjithashtu edhe detyrimet për të paguar mjete monetare në të ardhmen dhe burimet që paraqesin mjete monetare për t'u arkëtuar në të

ardhmen. Kështu, ato japin llojin e informacionit rreth transaksioneve dhe ngjarjet e tjera në të shkuarën që është më shumë i dobishëm për përdoruesit në marrjen e vendimeve ekonomike.

Vijimësia

- 23 Pasqyrat financiare normalisht përgatiten mbi supozimin se një njësi ekonomike është në një vijimësi dhe do të vazhdojë të funksionojë në një të ardhme të parashikueshme. Kështu, supozohet që njësi ekonomike as nuk ka synimin dhe as nuk ka nevojë të likuideojë ose të shkurtojë materialisht shkallën e operacioneve të saj; nëqoftëse ky synim ose kjo nevojë ekziston, pasqyrat financiare do të duhet të përgatiten mbi një bazë të ndryshme dhe, nëqoftëse është ky rasti, baza e përdorur jepet në informacionet shpjeguese.

Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare

- 24 Karakteristikat cilësore janë veti që e bëjnë informacionin e dhënë në pasqyrat financiare të dobishëm për përdoruesit. Katër karakteristikat cilësore kryesore janë kuptueshmëria, përkatësia, besueshmëria dhe krahasueshmëria.

Kuptueshmëria

- 25 Një cilësi themelore e informacionit të dhënë në pasqyrat financiare është që ai të jetë menjëherë i kuptueshëm nga përdoruesit. Për këtë qëllim, përdoruesit supozohet se kanë njohuri të arsyeshme për biznesin dhe veprimtaritë ekonomike dhe kontabilitetin dhe një vullnet për të studjuar informacionin me kujdesin e duhur. Megjithatë, informacioni rreth çështjeve komplekse që duhet të përfshihet në pasqyrat financiare për arsye të përkatësisë së tij për nevojat e marrjes së vendimeve nga përdoruesit nuk duhet të lihet jashtë vetëm për arsyen se ai mund të jetë shumë i vështirë për t'u kuptuar nga disa përdorues.

Përkatësia

- 26 Që të jetë i dobishëm, informacioni duhet të jetë përkatës për nevojat e marrjes së vendimeve nga përdoruesit. Informacioni ka cilësinë e përkatësisë kur ai influencën vendimet ekonomike të përdoruesve duke i ndihmuar ata të vlerësojnë ngjarjet e shkuara, aktuale ose të ardhshme apo për të konfirmuar, ose korrigjuar, vlerësimet e tyre të mëparshme.
- 27 Rolet parashikuese dhe konfirmuese të informacionit janë të ndërthurura. Për shembull, informacioni rreth nivelit dhe strukturës aktuale të aktiveve të mbajtura ka vlerë për përdoruesit kur ata përpiqen të parashikojnë aftësinë e njësisë ekonomike për të përfituar nga mundësitë dhe aftësitë e saj për të kundërvepruar ndaj situatave të mbrapshta. I njëjti informacion luan një rol konfirmues në lidhje me parashikimet e mëparshme rreth, për shembull, mënyrës me të cilën njësi ekonomike duhet të strukturohet apo me rezultatin e operacioneve të planifikuara.
- 28 Informacioni rreth gjendjes financiare dhe performancës në të shkuarën përdoret shpesh si bazë për parashikimin e gjendjes financiare dhe performancën në të ardhmen dhe çështje të tjera për të cilat përdoruesit janë drejtpërdrejt të interesuar, të tilla si pagesat e dividendit dhe pagat, lëvizjet e çmimit të letrave me vlerë dhe aftësinë e njësisë ekonomike për të plotësuar angazhimet e saj në kohën e duhur. Për të pasur vlerë parashikuese, informacioni nuk ka nevojë të jetë në formën e një parashikimi të veçantë. Aftësia për të bërë parashikime nga pasqyrat financiare rritet nga mënyra me të cilën paraqitet informacioni për transaksionet dhe ngjarjet e shkuara. Për shembull, vlera parashikuese e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve rritet nëse elementë të pazakontë, jo normalë dhe jo të shpeshtë të të ardhurave dhe shpenzimeve jepen veças.

Materialiteti

- 29 Përkatësia e informacionit ndikohet nga natyra dhe materialiteti i tij. Në disa raste, vetëm natyra e informacionit mjafton për të përcaktuar përkatësinë e tij. Për shembull, raportimi i një segmenti të ri mund të ndikojë vlerësimin e rreziqeve dhe mundësisë që përballet njësi ekonomike pavarësisht nga materialiteti i rezultateve të arritura nga segmenti i ri në periudhën raportuese. Në rastet e tjera, të dyja edhe natyra edhe materialiteti janë të rëndësishme, për shembull, shumat e inventareve të mbajtura në secilën kategori që janë të përshtatshme për biznesin.
- 30 Informacioni është material nëse mungesa ose anomali të tij mund të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbështetur në pasqyrat financiare. Materialiteti varet nga madhësia e elementit ose gabimit të gjykuar në rrethana të veçanta të mungesës ose keqdeklarimit të tij. Kështu, materialiteti jep një kufi minimal

ose një pikë ndarjeje dhe nuk është një karakteristikë cilësore kryesore të cilën duhet ta ketë informacioni që ai të jetë i dobishëm.

Besueshmëria

- 31 Që të jetë i dobishëm, informacioni gjithashtu duhet të jetë i besueshëm. Informacioni ka cilësinë e besueshmërisë kur ai është pa gabime materiale dhe shtrëmbërime dhe përdoruesit mund të mbështeten në të se ai paraqet me besnikëri atë që ose ai ka synuar të paraqesë ose atë që ai mund të pritët me arsyeshmëri të paraqesë.
- 32 Informacioni mund të jetë përkatës por jo i besueshëm në natyrë ose paraqitje kështu njohja e tij mund të jetë potencialisht keq rrëfyese. Për shembull, nëqoftëse vlefshmëria dhe shuma e një pretendimi për dëme sipas një veprimi ligjor janë kundërshtuar, do të ishte e papërshtatshme për njësinë ekonomike që të njëjtte shumën e plotë të pretendimit në bilanc, megjithëse do të ishte e përshtatshme që të jepej informacion shpjegues për shumën dhe rrethanat e pretendimit.

Paraqitja me besnikëri

- 33 Që të jetë i besueshëm, informacioni duhet të paraqesë me besnikëri transaksionet dhe ngjarjet e tjera që synohen të paraqiten ose mund të pritët me arsyeshmëri të paraqiten. Kështu, për shembull, një bilanc duhet të paraqesë me besnikëri transaksionet dhe ngjarjet e tjera që rezultojnë në aktive, detyrime dhe kapitalin e vet të njësisë ekonomike në datën e raportimit të cilat plotësojnë kriteret e njohjes.
- 34 Shumica e informacionit financiar është subjekt i njëfarë rreziku për të qënë më pak seç duhet një paraqitje me besnikëri për atë që ai synon të portretizojë. Kjo nuk i detyrohet shtrëmbërimit, por vështirësive të vetvetishme qoftë për të identifikuar transaksionet dhe ngjarjet e tjera që duhet të maten ose qoftë në përgatitjen dhe zbatimin e teknikave të vleresims dhe paraqitjes që mund të përcjellin mesazhe që korrespondojnë me këto transaksione dhe ngjarje. Në disa raste, matja e efekteve financiare të elementëve mund të jetë aq e pasigurtë sa që në përgjithësi njësitë ekonomike nuk i njohin ato në pasqyrat financiare; për shembull, megjithëse shumica e njësisë ekonomike gjenerojnë vetë emër të mirë në kohë, ky emër i mirë zakonisht është i vështirë të identifikohet ose të matet me besueshmëri. Në raste të tjera, megjithatë, mund të jetë përkatës për të njohur elementët dhe për të dhënë informacion shpjegues për rrezikun e gabimit që rrethon njohjen dhe vleresimn e tyre.

Përmbajtja mbi formën

- 35 Nëqoftëse informacioni duhet të paraqesë me besnikëri transaksionet dhe ngjarjet e tjera që ai synon të paraqesë, është e nevojshme që ato të kontabilizohen dhe të paraqiten në përputhje me përmbajtjen e tyre dhe realitetin ekonomik dhe jo vetëm sipas formës së tyre ligjore. Përmbajtja e transaksioneve ose ngjarjeve të tjera nuk është gjithnjë e njëjtë me atë që është e dukshme nga forma e tyre ligjore ose e sajuar. Për shembull, një njësi ekonomike mund të shesë një aktiv një pale të tretë në të tillë mënyrë që dokumentacioni të synojë të kalojë pronësinë ligjore tek kjo palë; pavarësisht nga kjo, mund të ekzistojnë marrëveshje që sigurojnë se njësia ekonomike të vazhdojë të gëzojë përfitimet ekonomike në të ardhmen të trupëzuara në aktiv. Në këto rrethana, raportimi i një shitje nuk do të paraqiste me besnikëri transaksionin e kryer (natyrisht nëqoftëse ka pasur një transaksion).

Neutraliteti

- 36 Që të jetë i besueshëm, informacioni që përmbajnë pasqyrat financiare duhet të jetë neutral, që do të thotë, pa shtrëmbërime. Pasqyrat financiare nuk janë neutrale nëqoftëse, prej zgjedhjes ose paraqitjes së informacionit, ato ndikojnë në marrjen e një vendimi ose bërjen e një gjykimi në mënyrë që të arrijnë një rezultat ose përfundim të paracaktuar.

Kujdesi

- 37 Përgatitësit e pasqyrave financiare, megjithatë, duhet të merren me pasiguritë që në mënyrë të pashmangëshme rrethojnë shumë ngjarje dhe rrethana, të tilla si arkëtueshmëria e llogarive të arkëtueshme të dyshimta, jeta e dobishme e mundshme e makinerive dhe pajisjeve dhe një numër pretendimesh për garanci që mund të ndodhin. Këto pasiguri njihen duke dhënë informacion shpjegues për natyrën dhe shtrirjen e tyre dhe duke ushtruar kujdesin në përgatitjen e pasqyrave financiare. Kujdesi është përfshirja e një shkalle maturie në ushtrimin e gjykimeve të nevojshme kur bëhen vlerësimet e kërkuara sipas kushteve të pasigurisë, të tilla që aktivet ose të ardhurat nuk mbivlerësohen dhe detyrimet ose shpenzimet nuk nënvlerësohen. Megjithatë, ushtrimi i kujdesit nuk lejon, për shembull, krijimin e rezervave të fshehta ose provizioneve të tepërta, nënvlerësimin e paramenduar

të aktiveve ose të ardhurave, ose mbivlerësimin e paramenduar të detyrimeve ose të shpenzimeve, për arsyen që pasqyrat financiare nuk do të jenë neutrale dhe, për këtë, nuk kanë cilësinë e besueshmërisë.

Plotësia

- 38 Që të jetë i besueshëm, informacioni në pasqyrat financiare duhet të jetë i plotë brenda kufijëve të materialitetit dhe kostos. Një mungesë mund të shkaktojë që informacioni të bëhet fallco ose keq rrëfyes dhe kështu jo i besueshëm dhe i mangët përse i përket përkatësisë së tij.

Krahasueshmëria

- 39 Përdoruesit duhet të kenë mundësi të krahasojnë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike në kohë të ndryshme në mënyrë që të identifikojnë tendencat në gjendjen financiare dhe rezultatin e saj financiar. Përdoruesit gjithashtu duhet të kenë mundësi të krahasojnë pasqyrat financiare të njësie ekonomike në mënyrë që të vlerësojnë gjendjen financiare, rezultatin financiar dhe ndryshimet në gjendjen financiare relative të tyre. Kështu, matja dhe paraqitja e efektit financiar të transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera të ngjashme duhet të kryhet në mënyrë të njëjtë për të gjithë një njësi ekonomike dhe gjatë gjithë kohës për këtë njësi ekonomike dhe në një mënyrë të njëjtë për njësitë ekonomike të ndryshme.
- 40 Një ndërthurje e rëndësishme e karakteristikës cilësore të krahasueshmërisë është që përdoruesit duhet të informohen për politikat kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare, çdo ndryshim në këto politika dhe efektet e këtyre ndryshimeve. Përdoruesit kanë nevojë të identifikojnë diferencat mes politikave kontabël për transaksionet dhe ngjarjet e tjera të ngjashme të përdorura nga e njëjta njësi ekonomike nga njëra periudhë në tjetrën dhe nga njësi ekonomike të ndryshme. Pajteshmëria me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese për politikat kontabël të përdorura nga njësi ekonomike, ndihmon arritjen e krahasueshmërisë.
- 41 Nevoja për krahasueshmëri nuk duhet të ngatërrohet me uniformitetin në vetvete dhe nuk duhet të lejohet të bëhet një pengesë për vënien në zbatim të standardeve të kontabilitetit të përmirësuara. Nuk është e përshtatshme për një njësi ekonomike të vazhdojë kontabilizimin në të njëjtën mënyrë të një transaksioni ose ngjarjeje tjetër nëqoftëse politika e zbatuar nuk i përmbahet karakteristikave cilësore të përkatësisë dhe besueshmërisë. Gjithashtu është e papërshtatshme për një njësi ekonomike t'i lërë politikat e saj kontabël të pandryshuara kur ekzistojnë alternative të tjera më përkatëse dhe më të besueshme.
- 42 Për arsyen se përdoruesit dëshirojnë të krahasojnë gjendjen financiare, rezultatin financiar dhe ndryshimet në gjendjen financiare të një njësie ekonomike në kohë, është e rëndësishme që pasqyrat financiare të tregojnë informacionin korresponues për periudhat e mëparshme.

Kufizimet ndaj informacionit përkatës dhe të besueshëm

Përshtatshmëria në kohë

- 43 Nëqoftëse ka një vonesë të pajustificuar në raportimin e informacionit ai mund të humbasë përkatësinë e tij. Drejtimin mund t'i duhet të ballancojë vlerën relative të raportimit në kohën e përshtatshme me dhënien e informacionit të besueshëm. Për të dhënë informacion në kohën e duhur shpesh mund të duhet të raportohet përpara se të gjitha aspektet e një transaksioni ose ngjarjeje tjetër të bëhen të ditura, kështu dëmtohet besueshmëria. Nga ana tjetër, nëqoftëse raportimi shtyhet derisa të bëhen të ditura të gjitha aspektet, informacioni mund të jetë shumë i besueshëm por pak i dobishëm për përdoruesit sepse ata ndërkohë kanë marrë vendimet. Për të arritur një drejtpeshim mes përkatësisë dhe besueshmërisë, konsiderata mbizotëruese është se si mund të kënaqim më mirë nevojat e përdoruesve në marrjen e vendimeve ekonomike.

Peshimi mes përfitimit dhe kostos

- 44 Peshimi mes përfitimit dhe kostos është një kufizim depërtues dhe jo një karakteristikë cilësore. Përfitimet e nxjerra nga informacioni duhet të tejkalojnë koston e dhënies së tij. Vlerësimi i përfitimeve dhe kostos, megjithatë, është në thelb një proces gjykimi. Veç kësaj, koston jo domosdoshmërisht bien mbi ata përdorues të cilët gëzojnë përfitimet. Përfitimet gjithashtu mund të merren nga përdorues të tjerë prej atyre për të cilët është përgatitur informacioni; për shembull, dhënia e informacionit të mëtejshëm për huadhënësit mund të ulë koston e huamarrjes të një njësie ekonomike. Për këto arsye, është e vështirë të zbatohet një test kosto-përfitim në secilin rast të veçantë. Pavarësisht nga kjo, përcaktuesit e standardeve në veçanti, si edhe përgatitësit dhe përdoruesit e pasqyrave financiare, duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë kufizim.

Drejtëshimi mes karakteristikave cilësore

- 45 Në praktikë drejtëshimi, ose këmbyeshmëria, mes karakteristikave cilësore shpesh është e nevojshme. Në përgjithësi qëllimi është të arrihet një drejtëshim i përshtatshëm mes karakteristikave në mënyrë që të plotësohet objektivi i pasqyrave financiare. Rëndësia relative e karakteristikave në raste të ndryshme është çështje e gjykitit profesional.

Pamja e vërtetë dhe e sinqertë/paraqitja e sinqertë

- 46 Pasqyrat financiare shpesh përshkruhen se tregojnë një pamje të vërtetë dhe të sinqertë, ose paraqesin me sinqeritet, gjendjen financiare, rezultatit financiar dhe ndryshimet në gjendjen financiare të një njësie ekonomike. Megjithatë ky *Kuadër* nuk trajton drejtpërdrejtë këto koncepte, zbatimi i karakteristikave cilësore kryesore dhe i standardeve të përshtatshme të kontabilitetit normalisht rezultojnë në pasqyra financiare që përcjellin atë çfarë kuptohet në përgjithësi si një pamje e vërtetë dhe e sinqertë, ose si paraqitje me sinqeritet e këtij informacioni.

Elementët e pasqyrave financiare

- 47 Pasqyrat financiare portretizojnë efektet financiare të transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera duke grupuar ato në klasa të gjëra sipas karakteristikave të tyre ekonomike. Këto klasa të gjëra janë quajtur elementët e pasqyrave financiare. Elementët që lidhen drejtpërdrejt me vlerësimin e gjendjes financiare në bilanc janë aktivet, detyrimet dhe kapitali i vet. Elementët që lidhen drejtpërdrejt me vlerësimin e rezultatit financiar në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve janë të ardhurat dhe shpenzimet. Pasqyra e ndryshimeve në gjendjen financiare pasqyron zakonisht elementët e pasqyrës së të ardhurave e shpenzimeve dhe ndryshimet në elementët e bilancit; përkatësisht, ky *Kuadër* nuk identifikon asnjë element që është unik për këtë pasqyrë.
- 48 Paraqitja e këtyre elementëve në bilanc dhe në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve përfshin një proces të nën-klasifikimit. Për shembull, aktivet dhe detyrimet mund të klasifikohen sipas natyrës ose funksionit të tyre në biznesin e njësisë ekonomike në mënyrë që të paraqitet informacioni në formën më të dobishme për përdoruesit për qëllimet e marrjes së vendimeve ekonomike.

Gjendja financiare

- 49 Elementët që lidhen drejtpërdrejtë me vlerësimin e gjendjes financiare janë aktivet, detyrimet dhe kapitali i vet. Këto përkufizohen si mëposhtë:
- (a) Një aktiv është një burim i kontrolluar nga njësisë ekonomike si rezultat i ngjarjeve të shkuara nga të cilat priten përfitime ekonomike në të ardhmen që të rrjedhin tek njësisë ekonomike.
 - (b) Një detyrim është një detyrim aktual i njësisë ekonomike që vjen nga ngjarje të shkuara, shlyerja e të cilit pritet të rezultojë në një dalje nga njësisë ekonomike të burimeve që trupëzojnë përfitimet ekonomike.
 - (c) Kapitali i vet është interesi i mbetur në aktivet e njësisë ekonomike mbasi zbriten të gjitha detyrimet e saj.
- 50 Përkufizimet e një aktivi dhe një detyrimi identifikojnë tiparet e tyre themelore por nuk synojnë të specifikojnë kriteret që nevojiten të plotësohen përpara se ato të njihen në bilanc. Kështu, përkufizimet përmbledhin elementët që nuk njihen si aktive ose detyrime në bilanc sepse ato nuk kënaqin kriteret për njohjen të trajtuara në paragrafët 82 deri 98. Veçanërisht, pritsshmëria që do të rrjedhin përfitime ekonomike në të ardhmen tek ose nga një njësi ekonomike duhet të jetë e sigurtë mjaftueshëm për të plotësuar kriterin e mundësisë në paragrafin 83 përpara se të njihet një aktiv ose detyrim.
- 51 Për vlerësimin nëse një element plotëson përkufizimin e një aktivi, detyrimi ose kapitali i vet, nevojitet t'i kushtohet vëmendje përmbajtjes së tij dhe realitetit ekonomik dhe jo vetëm formës së tij ligjore. Kështu, për shembull, në rastin e qirasë financiare, përmbajtja dhe realiteti ekonomik janë të tilla që qiramarrësi blen përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivitetit të marrë me qira për pjesën kryesore të jetës së tij të dobishme në këmbim të marrjes së një detyrimi për të paguar për këtë të drejtë një shumë përafërsisht me vlerën e drejtë të aktivitetit dhe shpenzimit përkatës financiar. Prandaj, qiraja financiare krijon elementë që kënaqin përkufizimin e një aktivi dhe një detyrimi dhe njihen si të tillë në bilancin e qiramarrësit.
- 52 Bilanci i përgatitur në përputhje me Standardet aktuale Ndërkombëtare të Kontabilitetit mund të përfshijë elementë që nuk kënaqin përkufizimet e një aktivi ose detyrimi dhe nuk paraqiten si pjesë e kapitalit të vet. Përkufizimet e parashikuara në paragrafin 49, megjithatë, do t'i nënshtrohen rishikimeve në të ardhmen të Standardeve aktuale Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe formulimit të Standardeve të tjera.

Aktivitet

- 53 Përfitimi ekonomik në të ardhmen i trupëzuar në një aktiv është mundësi për të kontribuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në fluksin e mjeteve monetare dhe equivalentëve të tyre për njësinë ekonomike. Mundësia mund të jetë prodhuese që është pjesë e veprimtarive operacionale të njësisë ekonomike. Gjithashtu ajo mund të jetë në formën e konvertimit në mjete monetare ose ekuivalentë të tyre ose një aftësi për të ulur daljen e mjeteve monetare, të tilla si në rastin kur një proces alternativ i përpunimit ul kostot e prodhimit.
- 54 Zakonisht një njësi ekonomike shfrytëzon aktivet e saj për të prodhuar mallra ose shërbime të afta të kënaqin dëshirat ose nevojat e klientëve; për arsye se këto mallra ose shërbime mund të kënaqin këto dëshira ose nevoja, klientët janë të përgatitur të paguajnë për to dhe kështu të kontribuojnë në fluksin e mjeteve monetare për njësinë ekonomike. Mjetet monetare në vetvete japin një shërbim për njësinë ekonomike për arsye të mbizotërimit të tyre ndaj burimeve të tjera.
- 55 Përfitimet ekonomike në të ardhmen të trupëzuara në një aktiv mund të rrjedhin tek njësi ekonomike në një numër mënyrash. Për shembull, një aktiv mundet të:
- (a) përdoret i vetëm ose i kombinuar me aktive të tjera në prodhimin e mallrave ose shërbimeve për t'u shitur nga njësi ekonomike;
 - (b) këmbëhet me aktive të tjera;
 - (c) përdoret për të shlyer një detyrim; ose
 - (d) shpërndahet për pronarët e njësisë ekonomike.
- 56 Shumë aktive, për shembull, aktivet afatgjata materiale kanë një formë fizike. Megjithatë, forma fizike nuk është themelore për ekzistencën e një aktivi; derisa patentat dhe të drejtat e autorit, për shembull, janë aktive nëqoftëse përfitimet ekonomike në të ardhmen rrjedhin prej tyre për njësinë ekonomike dhe nëqoftëse ato kontrollohen nga njësi ekonomike.
- 57 Shumë aktive, për shembull, llogaritë e arkëtueshme dhe pasuria, shoqërohen me të drejta ligjore, përfshirë të drejtën e pronësisë. Për të përcaktuar ekzistencën e një aktivi, e drejta e pronësisë nuk është themelore; kështu, për shembull, prona e mbajtur me qira është një aktiv nëqoftëse njësi ekonomike kontrollon përfitimet që priten të rrjedhin nga prona. Megjithatë aftësia e një njësie ekonomike për të kontrolluar përfitimet zakonisht është rezultat i të drejtave ligjore, një element mundet megjithatë të kënaqë përkufizimin e një aktivi edhe kur nuk ka kontroll ligjor. Përshembull, njohuritë e marra nga një veprimtari zhvillimi mund të plotësojnë përkufizimin e një aktivi kur, duke e mbajtur sekret këtë njohuri, një njësi ekonomike kontrollon përfitimet që priten të rrjedhin prej saj.
- 58 Aktivitet e një njësie ekonomike rezultojnë nga transaksione të shkuara ose ngjarje të tjera të shkuara. Normalisht njësitë ekonomike marrin aktivet nga blerja ose prodhimi i tyre, por edhe transaksione ose ngjarje të tjera mund të gjenerojnë aktive; shembujt përfshijnë pronën e përfutur prej një njësie ekonomike nga qeveria si pjesë e një programi për të inkurajuar rritjen ekonomike në një zonë dhe zbulimin e rezervave minerare. Transaksionet ose ngjarjet e tjera që priten të ndodhin në të ardhmen nuk krijojnë në vetvete aktive; kështu, për shembull, një synim për të blerë inventar, në vetvete, nuk plotëson përkufizimin e një aktivi.
- 59 Ka një shoqërim të ngushtë mes kryerjes së shpenzimeve dhe prodhimit të aktiveve por këto të dyja jo domosdoshmërisht përkrijnë me njëra tjetrën. Kështu, kur një njësi ekonomike kryen shpenzime, kjo mund të japë evidencë se janë kërkuar përfitime ekonomike në të ardhmen por kjo nuk është provë përfundimtare që një element kënaq përkufizimin se është marrë një aktiv. Në mënyrë të ngjashme mungesa e një shpenzimi të lidhur nuk përjashton një element nga kënaqja e përkufizimit të një aktivi dhe kështu të bëhet një kandidat për t'u njohur në bilanc; për shembull, elementët që i janë dhuruar njësisë ekonomike mund të kënaqin përkufizimin e një aktivi.

Detyrimet

- 60 Një karakteristikë themelore e një detyrimi është se njësi ekonomike ka një detyrim aktual. Një detyrim është një detyrë ose përgjegjësi për të vepruar ose kryer në një mënyrë të caktuar. Detyrimet mund të jenë të zbatueshme me ligj si rrjedhim e një kontrate të lidhur ose kërkesë logjore. Ky është normalisht rasti, për shembull, për shumat e pagueshme për mallrat dhe shërbimet e marra. Megjithatë, detyrimet gjithashtu krijohen, nga praktika normale e biznesit, zakonet dhe nga dëshira për të mbajtur marrëdhënie të mira biznesi ose për të vepruar në një mënyrë të drejtë. Nëqoftëse, për shembull, një njësi ekonomike vendos si një çështje të politikës së saj të riparojë të gjitha difektet e produkteve të saj edhe kur këto ndodhin dukshëm mbas periudhës së garancisë, shumat që priten të shpenzohen në lidhje me mallrat tashmë të shitura janë detyrime.
- 61 Është e nevojshme të bëhet një dallim mes një detyrimi aktual dhe një angazhimi të ardhshëm. Një vendim i drejtimit të një njësie ekonomike për të blerë aktive në të ardhmen, në vetvete, nuk krijon një detyrim aktual. Normalisht një detyrim krijohet vetëm kur aktivi lëvrohet ose njësi ekonomike arrin një marrëveshje të

pakthyeshme për të blerë aktivin. Në rastin e fundit, natyra e pakthyeshme e marrëveshjes kuptohet që pasojat ekonomike për të mos respektuar detyrimin, për shembull, për arsye të ekzistencës të një penalteti të lartë, lënë njësinë ekonomike pa ndonjë mundësi për të shmangur daljen e burimeve për një palë të tretë.

62 Shlyerja e një detyrimi aktual zakonisht përfshin njësinë ekonomike që jep burimet që kanë të trupëzuar përfitimet ekonomike në mënyrë që të kënaqin pretendimin e palës tjetër. Shlyerja e një detyrimi aktual mund të bëhet në një numër mënyrash, për shembull, me:

- (a) pagesën e mjeteve monetare;
- (b) transferimin e aktiveve të tjera;
- (c) dhënien e shërbimeve;
- (d) zëvendësimin e këtij detyrimi me një detyrim tjetër; ose
- (e) konvertimin e detyrimit me kapitalin e vet.

Një detyrim gjithashtu mund lahet me mjete të tjera, të tilla si një dorëheqje e kreditorit ose parashkrimi i të drejtave të tij.

63 Detyrimet rezultojnë nga transaksione të shkuara ose ngjarje të tjera të shkuara. Kështu, për shembull, blerja e mallrave dhe përdorimi i shërbimeve krijojnë detyrime tregtare (përveç rastit kur paguhen paradhënie ose në momentin e lëvrimit) dhe marrja e një huaje bankare rezulton në një detyrim për të ripaguar huanë. Një njësi ekonomike gjithashtu mund të njohë zbritjet e ardhëshme bazuar mbi blerjet vjetore nga klientët si detyrime; në këtë rast, shitja e mallrave në të kaluarën është transaksioni që krijon detyrimin.

64 Disa detyrime mund të maten vetëm duke përdorur një nivel të lartë çmuarje. Disa njësi ekonomike i përshkruajnë këto detyrime si provizione. Në disa vende, këto provizione nuk trajtohen si detyrime për arsye se koncepti i një detyrimi përkufizohet ngushtë në atë mënyrë që të përfshijë vetëm shumat që mund të caktohen pa nevojën e bërjes së çmuarjeve. Përkufizimi i një detyrimi në paragrafin 49 ndjek metodën më të gjerë. Kështu, kur një provizion përfshin një detyrim aktual dhe kënaq pjesën tjetër të përkufizimit, ai është një detyrim edhe nëqoftëse shuma do të duhet të çmohet. Shembujt përfshijnë provizionet për pagesat e bëra sipas garancive ekzistuese dhe provizionet për të mbuluar detyrimet e pensioneve.

Kapitali i vet

65 Megjithëse kapitali i vet përkufizohet në paragrafin 49 si një mbetje, ai mund të nën-klasifikohet në bilanc. Për shembull, në një njësi ekonomike të themeluar, fondet që janë kontribute të aksionerëve, fitimet e pashpërndara, rezervat që paraqesin përshtatjen e fitimeve të pashpërndara dhe rezervat që paraqesin rregullimet për mbajtjen e kapitalit mund të tregohen veças. Ky klasifikim mund të jetë i përshtatshëm për nevojat e marrjes së vendimeve nga përdoruesit e pasqyrave financiare kur ato tregojnë kufizime ligjore ose të tjera mbi aftësinë e njësisë ekonomike për të shpërndarë ose ndryshe për të zbatuar kapitalin e vet. Ato gjithashtu mund të pasqyrojnë faktin se palët me interesa pronësie në një njësi ekonomike kanë të drejta të ndryshme në lidhje me marrjen e dividendëve ose pagimin e kontributit në kapitalin e vet.

66 Krijimi i rezervave ndonjëherë kërkohet nga statuti ose nga ligji në mënyrë që t'u japë njësisë ekonomike dhe kreditorëve të saj një masë shtesë për t'u mbrojtur nga efektet e humbjeve. Rezerva të tjera mund të krijohen nëqoftëse legjislacioni tatimor i vendit jep përjashtime nga, ose ulje në, detyrimet tatimore kur bëhen transferime në këto rezerva. Ekzistenca dhe madhësia e këtyre rezervave ligjore, statutore dhe tatimore është informacion që mund të jetë përkatës për nevojat e vendim marrjes së përdoruesve. Transferimet në këto rezerva janë kalime nga fitimet e pashpërndara dhe jo shpënzime.

67 Shuma me të cilën tregohet kapitali i vet në bilanc varet nga matja e aktiveve dhe detyrimeve. Normalisht, shuma e mbledhur e kapitalit të vet vetëm për koincidencë korrespondon me shumën e mbledhur të vlerës së tregut të aksioneve të njësisë ekonomike ose shumën që mund të arrihet nga shtija qoftë e aktiveve neto mbi një bazë pjesë-pjesë ose njësinë ekonomike si një e tërë mbi një bazë vijimësie.

68 Veprimtaritë tregtare, industriale dhe biznesi shpesh ndërmerren nëpërmjet njësisë ekonomike të tilla si pronari i vetëm, ortakëritë dhe fondet e investimeve dhe lloje të ndryshme të ndërmarrjeve qeveritare të biznesit. Kudri ligjor dhe rregullator për këto njësi ekonomike shpesh është i ndryshëm nga ai që zbatohet për shoqëritë tregtare. Për shembull, mund të ketë pak kufizime, nëse ka ndonjë, mbi shpërndarjen për pronarët ose përfitues të tjerë të shumave të përfshira në kapitalin e vet. Pavarësisht, përkufizimi i kapitalit të vet dhe aspektet e tjera të këtij Kudri që trajtojnë kapitalin e vet janë të përshtatshme për këto njësi ekonomike.

Rezultati financiar

69 Fitimi shpesh përdoret si një masë e performancës (rezultatit financiar) ose si një bazë për masa të tjera, të tilla si kthimi nga investimi ose fitimet për aksion. Elementët që lidhen drejtpërdrejt me vlerësimin e fitimit janë të

ardhurat dhe shpenzimet. Njohja dhe matja e të ardhurave dhe shpenzimeve, e kësisoj fitimit, varen pjesërisht nga koncepti i kapitalit dhe mbajtjes së kapitalit të përdorur nga njësia ekonomike në përgatitjen e pasqyrave të saj financiare. Këto koncepte diskutohen në paragrafët 102 deri 110.

- 70 Elementët e të ardhurave dhe shpenzimeve përkufizohen si mëposhtë:
- (a) E ardhura është rritje e përfitimeve ekonomike gjatë periudhës kontabël në formën e hyrjeve ose shtimeve të aktiveve, ose pakësimeve të detyrimeve që sjellin rritje të kapitalit të vet, të ndryshme nga ato të lidhura me kontributet nga pjesëmarrësit në kapitalin e vet.
 - (b) Shpenzimet janë ulje e përfitimeve ekonomike gjatë periudhës kontabël në formën e daljeve ose pakësime të aktiveve, ose marrjet e detyrimeve që sjellin ulje të kapitalit të vet, të ndryshme nga ato të lidhura me shpërndarjet për pjesëmarrësit në kapitalin e vet.
- 71 Përkufizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve identifikojnë tiparet e tyre thelbësore por nuk synojnë të specifikojnë kriteret që do të duhej që atë të plotësonin përpara se ato të njihen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve. Kriteret për njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve diskutohen në paragrafët 82 deri 98.
- 72 Të ardhurat dhe shpenzimet mund të paraqiten në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve në mënyra të ndryshme ashtu siç duhet për të dhënë informacionin që është përkatës për marrjen e vendimeve ekonomike. Për shembull, është një praktikë e përbashkët për të dalluar ato elementë të të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga veprimtaritë e zakonshme të njësisë ekonomike nga ato që nuk vijnë prej tyre. Ky dallim bëhet mbi bazën se burimi i një elementi është përkatës në vlerësimin e aftësisë së njësisë ekonomike për të gjeneruar mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në të ardhmen; për shembull, veprimtaritë e rastësishme të tilla si shitja e një investimi afatgjatë, ka pak mundësi të përsëritet mbi baza të rregullta. Kur bëjmë dallimin mes elementëve në këtë mënyrë duhet të jepen shpjegime për natyrën e njësisë ekonomike dhe veprimtarive të saj. Elementët që vijnë nga veprimtaritë e zakonshme të një njësie ekonomike mund të jenë të pazakonta në lidhje me një tjetër.
- 73 Dallimi mes elementëve të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kombinimi i tyre në mënyra të ndryshme gjithashtu lejon shfaqjen e disa masave të performancës së njësisë ekonomike. Këto kanë shkallë të ndryshme të përfshirjes. Për shembull, pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve mund të paraqesë marzhin bruto, fitimin ose humbjen nga veprimtaritë e zakonshme përpara tatimit, fitimin ose humbjen nga veprimtaritë e zakonshme mbas tatimit dhe fitimin ose humbjen.

Të ardhurat

- 74 Përkufizimi i të ardhurave përfshin si të ardhurat ashtu edhe përfitimet. Të ardhurat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike dhe të cilave u referohemi me lloje të ndryshme emrash që përfshijnë shitjet, tarifatat, interesat, dividendët, honoraret dhe qiratë.
- 75 Përfitimet paraqesin elementë të tjerë që plotësojnë përkufizimin e të ardhurave dhe mundet, ose jo, të vijnë nga veprimtaritë e zakonshme të një njësie ekonomike. Përfitimet paraqesin rritje të përfitimeve ekonomike dhe si të tilla nuk janë të ndryshme në natyrë nga të ardhurat. Kështu, ato nuk trajtohen sikur përbëjnë një element të veçantë në këtë *Kuadër*.
- 76 Përfitimet përfshijnë, për shembull, ato që vijnë nga shitja e aktiveve afatgjatë. Përkufizimi i të ardhurave gjithashtu përfshin përfitimet e përcaktuara; për shembull, ato që vijnë nga rivlerësimi i letrave me vlerë të tregëtueshme dhe ato që rezultojnë nga rritja në vlerën kontabël e aktiveve afatgjata. Kur njihen përfitimet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve, ato zakonisht paraqiten veças sepse njohja e tyre është e dobishme për qëllimin e marrjes së vendimeve ekonomike. Përfitimet shpesh raportohen neto nga shpenzimet përkatëse.
- 77 Lloje të ndryshme aktivesh mund të merren ose përmirësohen nga të ardhurat; shembujt përfshijnë mjetet monetare, llogaritë e arkëtueshme dhe shërbimet e marra në këmbim të mallrave dhe shërbimeve të furnizuara. Të ardhurat gjithashtu mund të rezultojnë nga shlyerja e detyrimeve. Për shembull, një njësi ekonomike mund të japë mallra dhe shërbime për një huadhënës si shlyerje të një detyrimi për të ripaguar një hua pezull.

Shpenzimet

- 78 Përkufizimi i shpenzimeve përfshin humbjet si dhe ato shpenzime që kryhen në rrjedhën e veprimtarive të zakonshme të njësisë ekonomike. Shpenzimet që kryhen në rrjedhën e veprimtarive të zakonshme të njësisë ekonomike përfshijnë, për shembull, koston e shitjeve, pagat dhe amortizimin. Ato zakonisht marrin formën e një dalje ose pakësimi të aktiveve të tillë si mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre, inventari, dhe aktivet afatgjata materiale.
- 79 Humbjet paraqesin elementë të tjerë që plotësojnë përkufizimin e shpenzimeve dhe mundet, ose jo, të krijohen në rrjedhën e veprimtarive të zakonshme të njësisë ekonomike. Humbjet paraqesin ulje të përfitimeve ekonomike dhe si të tilla nuk janë të ndryshme në natyrë nga shpenzimet e tjera. Kështu, ato nuk trajtohen sikur përbëjnë një element të veçantë në këtë *Kuadër*.

- 80 Humbjet përfshijnë, për shembull, ato që rezultojnë nga katastrofat të tilla si zjarri dhe përmbytjet, si dhe ato që vijnë nga dalja e aktiveve afatgjata. Përkufizimi i shpenzimeve gjithashtu përfshin humbjet e parealizuar, për shembull, ato që krijohen nga efektet e rritjes së kursit të këmbimit të një monedhe të huaj në lidhje me huamarrjet e njësisë ekonomike në këtë monedhë. Kur njihen humbjet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve, ato zakonisht paraqiten veças sepse njohja e tyre është e dobishme për qëllimin e marrjes së vendimeve ekonomike. Humbjet shpesh raportohen neto nga të ardhurat përkatëse.

Rregullimet e mbajtjes së kapitalit

- 81 Rivlerësimi ose riparacitja e aktiveve dhe detyrimeve krijon rritje ose ulje në kapitalin e vet. Ndërsa këto rritje ose ulje plotësojnë përkufizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, ato nuk përfshihen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve sipas disa koncepteve të mbajtjes së kapitalit. Por këto elementë përfshihen në kapitalin e vet si rregullime të mbajtjes së kapitalit ose rezerva rivlerësimi. Këto koncepte të mbajtjes së kapitalit diskutohen në paragrafët 102 deri 110 të këtij *Kudri*.

Njohja e elementëve të pasqyrave financiare

- 82 Njohja është një proces i përfshirjes në bilanc ose në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve të një elementi që plotëson përkufizimin e një elementi dhe kënaq kriteret për njohjen të parashikuara në paragrafin 83. Ajo përfshin përshkrimin e elementit me fjalë dhe me një shumë monetare dhe përfshirjen e kësaj shume në totalin e bilancit ose të pasqyrës së të ardhurave e shpenzimeve. Elementët që kënaqin kriteret e njohjes duhet të njihen në bilanc ose në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve. Mos njohja e këtyre elementëve nuk ndreqet duke dhënë informacione shpjeguese për politikën kontabël të përdorura dhe as duke i paraqitur në shënimet e materialet e tjera shpjeguese.
- 83 Një element që plotëson përkufizimin e një elementi duhet të njihet nëqoftëse:
- (a) është e mundur që çdo përfitim ekonomik në të ardhmen që lidhet me këtë element do të rrjedhë tek ose nga njësi ekonomike; dhe
 - (b) elementi ka një kosto ose vlerë që mund të matet me besueshmëri.
- 84 Për të vlerësuar nëse një element plotëson këto kritere dhe për këtë kualifikohet për njohje në pasqyrat financiare, nevojitet të merren në konsideratë çështjet e materialitetit që diskutohen në paragrafët 29 dhe 30. Ndërvarësia mes elementëve kuptohet se një element që plotëson përkufizimin dhe kriteret e njohjes për një element të veçantë, për shembull, një aktiv, automatikisht kërkon njohjen e një elementi tjetër, për shembull, e ardhura ose detyrimi.

Mundësia e përfitimeve ekonomike në të ardhmen

- 85 Koncepti i mundësisë përdoret në kriteret e njohjes për t'ju referuar shkallës së pasigurisë që përfitimet ekonomike në të ardhmen që shoqërojnë elementin do të rrjedhin tek ose nga njësi ekonomike. Koncepti i përmbahet pasigurisë që karakterizon mjedisin në të cilin vepron një njësi ekonomike. Vlerësimet e shkallës së pasigurisë që i bashkëngjiten rrjedhjes së përfitimeve ekonomike në të ardhmen bëhen mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën kur përgatiten pasqyrat financiare. Për shembull, kur është e mundur që një llogari e arkëtueshme e zotëruar nga njësi ekonomike do të paguhet, atëherë është e justifikuar, në mungesë të ndonjë evidence kundërshtuese, të njihet llogaria e arkëtueshme si aktiv. Megjithatë, për një popullatë të madhe llogarish të arkëtueshme, një farë shkalle për mos-pagesë normalisht konsiderohet e mundur; kështu që njihet një shpenzim që paraqet uljen e pritshme të përfitimeve ekonomike.

Besueshmëria e matjes

- 86 Kriteri i dytë për njohjen e një elementi është që ai përmban një kosto ose vlerë që mund të matet me besueshmëri siç diskutohet në paragrafët 31 deri 38 të këtij *Kudri*. Në shumë raste, kosto ose vlera duhet të vlerësohet; përdorimi i vlerësimeve të arsyeshme është pjesë thelbësore e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe nuk prish besueshmërinë e tyre. Megjithatë, kur nuk mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm elementi nuk njihet në bilanc ose në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve. Për shembull, të ardhurat e pritshme nga një çështje gjyqësore mund të plotësojnë përkufizimet edhe të një aktivi dhe një të ardhure si edhe të kriterit të mundësisë për njohje; megjithatë, nëqoftëse pretendimi nuk është e mundur të matet me besueshmëri, nuk njihet si një aktiv ose si e ardhur; ekzistenca e pretendimit, megjithatë, duhet të jepet në shënimet shpjeguese, materialet sqaruese ose pasqyrat shtesë.

- 87 Një element që, në një moment të veçantë në kohë, nuk plotëson kriteret e njohjes në paragrafin 83 mund të kualifikohet për njohje në një kohë tjetër të mëvonëshme si rezultat i rrethanave ose ngjarjeve të mëpasme.
- 88 Një element që përmban karakteristikat themelore të një elementi por nuk plotëson kriteret e njohjes mundet megjithatë të jepet në informacionet në shënimet shpjeguese, materialet sqaruese ose në pasqyrat shitesë. Kjo është e përshtatshme kur kuptimi i elementit konsiderohet përkatës për vlerësimin e gjendjes financiare, rezultatit financiar dhe ndryshimeve në gjendjen financiare të një njësie ekonomike nga përdoruesit e pasqyrave financiare.

Njohja e aktiveve

- 89 Një aktiv njihet në bilanc kur është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen do të rrjedhin tek njësia ekonomike dhe aktivi ka një kosto ose vlerë që mund të matet me besueshmëri.
- 90 Një aktiv nuk njihet në bilanc kur janë kryer shpenzimet për të dhe konsiderohet e pamundur që përfitimet ekonomike që do të rrjedhin tek njësia ekonomike përtej periudhës kontabël aktuale. Por ky transaksion rezulton në njohjen e një shpenzimi në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve. Ky trajtim nuk implikon qoftë synimin e drejtimit se kryerja e shpenzimit ka qënë e ndryshme nga gjenerimi i përfitimeve ekonomike në të ardhmen për njësinë ekonomike ose qoftë që drejtimi ka qënë keqrrëfyes. I vetmi implikim është që shkalla e sigurisë që përfitimet ekonomike në të ardhmen do të rrjedhin tek njësia ekonomike përtej periudhës kontabël aktuale është i pamjaftueshëm për të garantuar njohjen si një aktiv.

Njohja e detyrimeve

- 91 Një detyrim njihet në bilanc kur është e mundur që një dalje e burimeve trupëzuar në përfitimet ekonomike do të rezultojë nga shlyerja e një detyrimi aktual dhe shuma me të cilën do të kryhet shlyerja mund të matet me besueshmëri. Në praktikë, detyrimet sipas kontratave që janë të pakryera proporcionalisht në mënyrë të njëjtë (për shembull, detyrimet për inventar të porositur por akoma të pa marrë) në përgjithësi nuk njihen si detyrime në pasqyrat financiare. Megjithatë, këto detyrime mund të plotësojnë përkufizimin e detyrimeve dhe, me kusht që të plotësohen kriteret e njohjes në rrethana të veçanta, mund të kualifikohen për t'u njohur. Në këto rrethana, njohja e detyrimeve sjell njohjen e aktiveve ose shpenzimeve përkatëse.

Njohja e të ardhurave

- 92 E ardhura njihet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve kur krijohet një rritje në përfitimet ekonomike në të ardhmen që lidhet me një rritje në një aktiv ose një ulje të një detyrimi dhe kur kjo mund të matet me besueshmëri. Në fakt kjo kuptohet, që njohja e të ardhurës ndodh njëkohësisht me njohjen e rritjes në aktivet ose uljes në detyrimet (për shembull, një rritje neto në aktivet që vjen nga një shitje mallrash ose shërbimesh ose një ulje në detyrimet që vjen nga parashkrimi i një borxhi të pagueshëm).
- 93 Proçedurat që zbatohen normalisht në praktikë për njohjen e të ardhurës, për shembull, kërkesa që të ardhurat duhet të fitohen, janë zbatime të kriterëve të njohjes në këtë *Kuadër*. Këto proçedura në përgjithësi drejtohen për kufizimin e njohjes si e ardhur të këtyre elementëve që mund të maten me besueshmëri dhe kanë një shkallë sigurie të mjaftueshme.

Njohja e shpenzimeve

- 94 Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve kur krijohet një ulje në përfitimet ekonomike në të ardhmen që lidhet me një ulje në një aktiv ose një rritje të një detyrimi dhe kur kjo mund të matet me besueshmëri. Në fakt kjo kuptohet, që njohja e shpenzimeve ndodh njëkohësisht me njohjen e një rritje në detyrimet ose me një ulje në aktivet (për shembull, konstatimi i të drejtave të punonjësve ose amortizimi i pajisjeve).
- 95 Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve mbi bazën e një shoqërizimi të drejtpërdrejtë mes kostove të kryera dhe përfitimin e një elementi të veçantë të të ardhurave. Ky proçes, që zakonisht i referohemi si ballafaqimi i kostove me të ardhurat, përfshin njohjen e njëkohëshme ose të kombinuar të të ardhurave dhe shpenzimeve që rezultojnë drejtpërdrejt dhe bashkarisht nga të njëjtit transaksione ose ngjarje të tjera; për shembull, përbërësit e ndryshëm të shpenzimit që bëjnë koston e mallrave të shitura njihen në të njëjtën kohë si të ardhura të nxjerra nga shitja e mallrave. Megjithatë, zbatimi i konceptit të ballafaqimit sipas këtij *Kuadri* nuk lejon njohjen e elementëve në bilanc që nuk plotësojnë përkufizimin e aktiveve ose detyrimeve.
- 96 Kur përfitimet ekonomike priten të krijohen gjatë disa periudhave kontabël dhe shoqërizimi me të ardhurën mundet të përcaktohet vetëm përafërsisht ose tërthorazi, shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve mbi bazën e proçedurave të shpërndarjes sistematike dhe racionale. Kjo shpesh është e nevojshme

kur njihen shpenzimet që shoqërojnë përdorimin e aktiveve të tilla si prona, instalimet, pajisjet, emri i mirë, patentat dhe markat tregëtare; në këto raste shpenzimi referohet si amortizim ose konsum. Këto procedura shpërndarje synojnë të njohin shpenzimet në periudhat kontabël në të cilat konsumohen ose skadojnë përfitimet ekonomike që shoqërojnë këto elementë.

- 97 Një shpenzim njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve kur një shpenzim nuk prodhon përfitime ekonomike në të ardhmen ose kur, dhe për aq sa ky, përfitimet ekonomike në të ardhmen nuk kualifikohen, ose pushojnë së kualifikuari, për njohje në bilanc si një aktiv.
- 98 Një shpenzim gjithashtu njihet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve edhe në ato raste kur një detyrim konstatohet pa u njohur një aktiv, si në rastin e krijimit të një detyrimi sipas garancisë së një produkti.

Matja e elementëve të pasqyrave financiare

- 99 Matja është procesi i përcaktimit të shumës monetare me të cilën elementët e pasqyrave financiare do të njihen dhe mbarten në bilanc dhe në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve. Kjo përfshin zgjedhjen e një baze të veçantë të vleresimi.
- 100 Përdoren një numër i ndryshëm bazash vleresimi për shkallë të ndryshme dhe në kombinime të ndryshme në pasqyrat financiare. Këto përfshijnë si mëposhtë:
- (a) *Kosto historike.* Aktivet rregjistrohen me shumën e paguar të mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre ose me vlerën e drejtë të shumës së dhënë për të blerë ato në kohën e blerjes së tyre. Detyrimet rregjistrohen me shumën e marrë të përfitimeve në këmbim të detyrimit, ose në disa rrethana (për shembull, tatimet mbi të ardhurat), me shumën e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre që pritet të paguhet për të kënaqur detyrimin në rrjedhën normale të biznesit.
 - (b) *Kosto aktuale.* Aktivet mbarten me shumën e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre që do duhej të paguheshin nëqoftëse blihet aktualisht i njëjti ose një aktiv ekuivalent. Detyrimet mbarten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre që do të duheshin për të shlyer detyrimin aktualisht.
 - (c) *Vlera e realizueshme (shlyerja).* Aktivet mbarten me shumën e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre që mund të merren aktualisht nga shitja e aktivit në një dalje të zakonshme. Detyrimet mbarten me vlerat e tyre të shlyerjes; që janë, shumat e paskontuara të mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre që pritet të paguhet për të kënaqur detyrimet në rrjedhën normale të biznesit.
 - (d) *Vlera aktuale.* Aktivet mbarten me vlerën aktuale të skontuar të hyrjeve të mjeteve monetare neto në të ardhmen që elementi pritet të gjenerojë në rrjedhën normale të biznesit. Detyrimet mbarten me vlerën aktuale të skontuar të daljeve të mjeteve monetare neto në të ardhmen që pritet të kërkohen për të shlyer detyrimet në rrjedhën normale të biznesit.
- 101 Baza e vleresimit e zbatuar në shumicën e rasteve nga njësitë ekonomike në përgatitjen e pasqyrave të tyre financiare është kosto historike. Kjo zakonisht kombinohet me baza të tjera vleresimi. Për shembull, inventarët zakonisht mbarten me më të ultën mes koston dhe vlerës neto të realizueshme, letrat me vlerë të tregueshme mbarten me vlerën e tregut dhe detyrimet e pensionit mbarten me vlerën e tyre aktuale. Veç kësaj, disa njësi ekonomike përdorin bazën e koston aktuale si një kundërveprim ndaj paaftësisë së modelit të kontabilitetit të koston historike për të trajtuar efektet e ndryshimeve të çmimeve të aktiveve jo-monetare.

Konceptet e kapitalit dhe mbajtjes së kapitalit

Konceptet e kapitalit

- 102 Një koncept financiar i kapitalit zbatohet nga shumica e njërive ekonomike në përgatitjen e pasqyrave të tyre financiare. Sipas konceptit financiar të kapitalit, të tilla si paratë e investuara ose fuqia blerëse e investuar, kapitali është sinonimi i aktiveve neto ose kapitalit të vet të njësisë ekonomike. Sipas konceptit fizik të kapitalit, të tilla si kapacitetet operationale, kapitali trajtohet si aftësi prodhuese e njësisë ekonomike bazuar në, për shembull, njësitë e produktit në ditë.
- 103 Zgjedhja e konceptit të përshtatshëm të kapitalit nga njësia ekonomike duhet të bazohet mbi nevojat e përdoruesve të paqyrave të saj financiare. Kështu, koncepti financiar i kapitalit duhet të zbatohet nëqoftëse përdoruesit e pasqyrave financiare janë të interesuar kryesisht për mbajtjen e kapitalit nominal të investuar ose fuqinë blerëse të kapitalit të investuar. Megjithatë, nëqoftëse interesimi kryesor i përdoruesve është për kapacitetet operationale të njësisë ekonomike, duhet të përdoret koncepti fizik i kapitalit. Koncepti i zgjedhur

tregon qëllimin që duhet të arrihet për përcaktimin e fitimit, edhe në rastin kur mund të ketë disa vështirësi vleresimi për ta bërë konceptin operacional.

Konceptet e mbajtjes së kapitalit dhe të përcaktimit të fitimit

- 104 Konceptet e kapitalit në paragrafin 102 sjellin konceptet e mëposhtëme të mbajtjes së kapitalit:
- (a) *Mbajtja financiare e kapitalit.* Sipas këtij koncepti një fitim përfitohet vetëm nëqoftëse shuma financiare (ose paratë) e aktiveve neto në fund të periudhës tejkalon shumën financiare (ose paratë) e aktiveve neto në fillim të periudhës, mbasi përjashtohen të gjitha shpërndarjet për, dhe kontributet nga, pronarët gjatë periudhës. Mbajtja financiare e kapitalit mund të matet ose me njësitë monetare nominale ose njësitë e fuqisë blerëse konstante.
 - (b) *Mbajtja fizike e kapitalit.* Sipas këtij koncepti një fitim përfitohet vetëm nëqoftëse kapaciteti fizik prodhues (ose kapaciteti operacional) i njësisë ekonomike (ose burimet ose fondet e nevojshme për të arritur këtë kapacitet) në fund të periudhës tejkalon kapacitetin fizik prodhues në fillim të periudhës, mbasi përjashtohen të gjitha shpërndarjet për, dhe kontributet nga, pronarët gjatë periudhës.
- 105 Koncepti i mbajtjes së kapitalit lidhet me se si një njësi ekonomike përcakton kapitalin që ajo kërkon të mbajë. Ai jep lidhjen mes koncepteve të kapitalit dhe koncepteve të fitimit për arsyen se ai jep pikën e referimit nga e cila matet fitimi; ai është një parakusht për të dalluar mes kthimit nga kapitali të njësisë ekonomike dhe kthimit të kapitalit të saj. Vetëm hyrjet e aktiveve që tejkalojnë shumat e nevojshme për mbajtjen e kapitalit mund të konsiderohen si fitim dhe për këtë si një kthim nga kapitali. Kështu, fitimi është shuma e mbetur që tepron mbasi zbriten shpenzimet (përfshirë rregullimet e mbajtjes së kapitalit, kur është rasti) nga të ardhurat. Nëqoftëse shpenzimet tejkalojnë të ardhurat shuma e mbetur është një humbje.
- 106 Koncepti i mbajtjes fizike të kapitalit kërkon zbatimin e vleresimit mbi bazën e kostos aktuale. Koncepti i mbajtjes financiare të kapitalit, megjithatë, nuk kërkon përdorimin e një baze të veçantë të vleresimit. Zgjedhja e bazës sipas këtij koncepti varet nga lloji i kapitalit financiar që njësi ekonomike kërkon të mbajë.
- 107 Diferenca kryesore mes dy koncepteve të mbajtjes së kapitalit është trajtimi i efekteve të ndryshimeve në çmimet e aktiveve dhe detyrimeve të njësisë ekonomike. Me terma të përgjithshme, një njësi ekonomike ka mbajtur kapitalin e saj nëqoftëse ajo ka në fund të periudhës aq kapital sa ajo kishte në fillim të periudhës. Çdo shumë mbi dhe që tejkalon shumën e kërkuar për të mbajtur kapitalin në fillim të periudhës është fitim.
- 108 Sipas konceptit të mbajtjes financiare të kapitalit kur kapitali përcaktohet në termat e njësisë monetare nominale, fitimi paraqitet si një rritje në kapitalin parë nominal gjatë periudhës. Kështu, rritjet në çmimet e aktiveve të mbajtura gjatë periudhës, që në mënyrë konvencionale u referohemi si përfitime të mbajtura, janë fitime nga pikëpamja konceptuale. Megjithatë, derisa aktivet të bëhen dalje në një transaksion këmbimi ato mund të mos njihen si të tilla. Kur koncepti i mbajtjes financiare të kapitalit përcaktohet në termat e njësisë konstante të fuqisë blerëse, fitimi paraqet rritjen në fuqinë blerëse të investuar gjatë periudhës. Kështu, vetëm ajo pjesë e rritjes në çmimet e aktiveve që tejkalon rritjen në nivelin e përgjithshëm të çmimeve konsiderohet si fitim. Pjesa tjetër e rritjes konsiderohet si një rregullim i mbajtjes së kapitalit dhe, për këtë, si pjesë e kapitalit të vet.
- 109 Sipas konceptit të mbajtjes fizike të kapitalit kur kapitali përcaktohet në termat e kapacitetit fizik prodhues, fitimi paraqet rritjen në këtë kapital gjatë periudhës. Të gjitha ndryshimet e çmimit që ndikojnë në aktivet dhe detyrimet e njësisë ekonomike shihen si ndryshime në vleresimin e kapacitetit fizik prodhues të njësisë ekonomike; kështu, ato trajtohen si rregullime të mbajtjes së kapitalit që janë pjesë e kapitalit të vet dhe jo si fitim.
- 110 Zgjedhja e bazës së vleresimit dhe konceptit të mbajtjes së kapitalit do të përcaktojë modelin kontabël që do të përdoret për përgatitjen e pasqyrave financiare. Modelet e ndryshme kontabël shfaqin shkallë të ndryshme të përkatësisë dhe besueshmërisë dhe, si edhe në aspekte të tjera, drejtimi duhet të kërkojë një drejtpeshim mes përkatësisë dhe besueshmërisë. Ky *Kuadër* zbatohet për një gamë të modeleve kontabël dhe jep udhëzime për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të ndërtuara sipas modelit të zgjedhur. Tani për tani, nuk është synimi i Bordit të KSNK të përshkruajë një model të veçantë përveçse në rrethana përjashtimore, të tilla si për ato njësi ekonomike që raportojnë në monedhën e një ekonomie hiperinflacioniste. Megjithatë, ky synim do të rishikohet në dritën e zhvillimeve botërore.

